



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 03.08.2026, të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej dymbëdhjetëmijë e njëqind euro (12,100 €) ndihmë për gjashtëdhjetegjashtë (66) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin korrik 2026, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0045749/26
Podujevë, datë 04.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17shkronja (g) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Raportit nr. prot.02-470/06-0045638/26 datë 04.08.2026, të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit të vlerësimit mbi gjendjen e krijuar nga mos grumbullimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës, Rekomandimin nr. prot. 02-052/09-0046029/26, datë 05.08.2026 të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit për shpalljen e gjendjes emergjente për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, Rekomandimin nr. 1337 të datës 05 .08.2026 të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe Rekomandimin e Shtabit Emergjent nga mbledhja e mbajtur më datë 05.08.2026, merr këtë:

V E N D I M **PËR SHPALLJEN E GJENDJES EMERGJENTE**

Neni 1

Shpallet gjendje emergjente në territorin e Komunës së Podujevës nga data **05.08.2026 deri më 05.11.2026**, për shkak të situatës së rënduar nga grumbullimi dhe mos tërheqja e mbeturinave nga operatorët kompetent, të cilat paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 2

-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit obligohet të hartoj dhe zbatojë planin operacional emergjent për organizimin dhe koordinimin e të gjitha masave emergjente për grumbullimin, transportimin dhe largimin e mbeturinave si dhe inicimin e procedurës së përsheptuar të prokurimit për sigurimin e tre (3) kamionëve me qira për bartjen e mbeturinave, duke përfshirë dhe tre shoferë, të cilët do të operojnë në kuadër të KRM Pastrimi.

-Drejtoria e Inspeksionit të intensifikojë mbikëqyrjen inspektuese dhe të marrë veprimet ligjore për parandalimin e deponive të paligjshme për mbrojtje të mjedisit, si dhe të ndërmarr masa administrative ndaj çdo shkelësi.

-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave obligohet të sigurojë mjete financiare dhe të ndërmarrë veprime të nevojshme për financimin e masave emergjente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Drejtoritë përkatëse raportojnë rregullisht te Kryetari i Komunës për masat e ndërmarra në kuadër të kompetencave të tyre dhe pas përfundimit të gjendjes emergjente përgatisin një raport përmbledhës mbi veprimet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet
Drejtorive përkatëse
Policisë së Kosovës- SP Podujevë
QSHQ / Arkivit

Nr.prot.02-016/01-0046169/26
Podujevë, datë: 05.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (g) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr

V E N D I M

Neni 1

Themelohet Komisioni për konstatimin e përfundimit të punimeve të projektit: *"Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës"*, i realizuar përmes një kredie të butë nga UniCredit Bank Austria AG, e garantuar dhe e mbështetur nga shteti Austriak, në këtë përbërje:

Veton Aliu, kryesues
Musli Kutleshi, anëtar
Kujtim Zhitia, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë:

Të vizitojë terrenin ku është realizuar projekti i kolektorit të ujërave të zeza.

Të verifikojë vizualisht dhe përmes dokumentacionit të disponueshëm gjendjen e projektit të përfunduar.

Të konstatojë përfundimin faktik të punimeve në projektin e lartë cekur.

Të hartojë një raport me shkrim mbi konstatimin e përfundimit të punimeve, i cili do të shërbejë ekskluzivisht për nevojat e Komunës.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer i paraqet Raport Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/cy-0046285/26
Podujevë, datë: 05.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 14 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 dhe nenin 14.3 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës, nr.prot.01-462/01-0062841/22, sipas Raportit/Rekomandimit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-463/06-0046530/26, datë 06.08.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. Shkëputet në mënyrë të njëanshme Kontrata e lidhur më 31.07.2026 në mes të Komunës së Podujevës, si dhënëse në shfrytëzim dhe z. Besim Bunjaku, nga fshati Sallabajë si shfrytëzues i Pronës së Paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit, e evidentuar në parcelën në fshatin Shakovicë, me sipërfaqe prej 330 m².

II. Shfrytëzuesi i deritanishëm obligohet që nga dita e pranimi të këtij vendimi, ta lirojë pronën e paluajtshme të përshkruar në pikën I të këtij vendimi dhe të njëjtën t'ia dorëzojë Komunës në gjendje të rregullt.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës dhe shfrytëzuesi z. Besim Bunjaku më datë 31.07.2026 kanë lidhur Kontratën për shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës, në fshatin Shakovicë, me sipërfaqe prej 330 m².

Drejtoria e Arsimit-DA më datë 06.08.2026 ka paraqitur Raport nr. prot. 02-463/06-0046530/26, datë 06.08.2026 me rekomandim për shkëputje të kontratës.

Sipas Raportit/Rekomandimit të DA prona në fjalë duhet të përfshihet në listën e pronave të veçanta për dhënie në shfrytëzim, duke shqyrtuar mundësitë e këmbimit të saj në interes të shkollës, pasi që e njëjta figuron në emër të shkollës dhe planifikohet të shfrytëzohet për nevoja të shkollës.

Nga se u tha më lartë në bazë të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës, nr.prot.01-462/01-0062841/22 si dhe Raportit/Rekomandimit të DA u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike

Pala e pakënaqur brenda afatit prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të iniciojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Nr.prot. 02-463/06-0046734/26
Podujevë, datë: 06.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, Ligjin e Punës nr.03/L-212 dhe neni 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë;

A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Podujevës, që të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e funksionit të Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe atë vetëm më datë 07.08.2026, për arsye të mungesës së drejtoreshës znj.Arbnorë Uka Osmani.

Nr. prot 02-046/01-0047108/26
Podujevë, datë 07.08.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë Tregtisë dhe Inovacionit dhe Komunës së Podujevës për realizimin e projektit “ Ndërtimi i Infrastrukturës së Parkut Industrial në Livadicë, Podujevë, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Ismet Kadriu, zyrtar në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në Komunën e Podujevës caktohet koordinator për përcjelljen e procesit dhe mbarëvajtjes së punimeve në kuadër të projektit “ Ndërtimi i Infrastrukturës së Parkut Industrial në Livadicë, Podujevë.

Neni 2

Punët dhe detyrat e koordinorit sipas nenit 1 të këtij vendimi janë në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë Tregtisë dhe Inovacionit dhe Komunës së Podujevës, datë 20.07.2026, si dhe rregullave tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Të caktuarit,

Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë Tregtisë dhe Inovacionit

Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA

QSHQ / Arkivi

Nr.Prot: 02-016/01-0048942/26
Podujevë, datë, 13.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet znj. Hamide Jashari, zyrtare në Zyrën e Prokurimit Publik të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga fushëveprimtaria e Zyrës, derisa z. Driton Kiçmari ushtrues i detyrës së udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit të kthehet nga pushimi vjetor.

Nr.prot. 02-016/01-0050303/26
Podujevë, datë: 18.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 16 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, për bashkëfinancim të ndërtimit të shtëpive familjeve në nevojë nr. prot. 02-016/01-0020976/26, datë 07.04.2026, merr:

V E N D I M

Neni 1

Formohet komisioni ad hoc i i përbashkët për përzgjedhjen e pesë (5) familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, përfituese të shtëpive të banimit që do të ndërtohen nga Shoqata Jetimat e Ballkanit në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

Arbresha Bashota, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kryesuese

Blerina Fejzullahu, Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit, anëtare

Albert Ajvazi, Drejtorja e Administratës, anëtar

Rinor Hakaj, përfaqësues nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, anëtar

Ferid Ibrahim, përfaqësues nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, anëtar

Neni 2

Punët dhe detyrat e Komisionit ndër të tjera janë: Verifikimi i aplikacioneve / kërkesave të paraqitura për ndërtimin e shtëpive të banimit, vlerësimi i tyre si dhe përzgjedhja e pesë (5) familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, përfituese të shtëpive të banimit që do të ndërtohen nga Shoqata bamirëse “ Jetimat e Ballkanit “ në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e Podujevës, sipas Marrëveshjes përkatëse të Bashkëpunimit nr. prot. 02-016/01-0020976/26, datë 07.04.2026, e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni përgatit Raport në formë të shkruar dhe të njëjtin ia dorëzon Kryetarit të Komunës dhe një kopje Shoqatës “ Jetimat e Ballkanit”.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet

Anëtarët e Komisionit, përmes DSHMS

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale- DSHMS

Shoqatës “ Jetimat e Ballkanit”

QSHQ/Arkiv

Nr.prot. 02-020/04-0050950/26
Podujevë, datë: 20.09.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës nr.prot.06-400/04-0049632/26, të datës 17.08.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Mevlude Halili, nga fshati Sfeçël, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtimin të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 1000€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

Znj.Mevlude Halili (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/04-0052139/26
Podujevë, datë, 24.08.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR, të datës 26.08.2026, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0046585/26, të datës 06.08.2026, për përkrahje në projektin me furnizim me mekanizëm bujqësor, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

-Ardian Emini, zyrtar i lartë për financa-DKA,
-Rrahmon Cakiqi, zyrtar i lartë për bujqësi - DBPZHR,
-Blerina Fejzullahu, zyrtare për Rini –DKRS,

kryesues
anëtar
anëtare

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve si dhe akteve të tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04 - 0052755/26
Podujevë, datë, 26.08.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet **znj.Ditjona Statovci**, Ushtruese e Detyrës së Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Administratës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural deri sa **z.Behram Latifi**, Ushtrues i Detyrës së Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi vjetor, apo deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 27.08.2026 deri më datën 07.09.2026.

Nr.Prot. 02-01661-0053373/26
Podujevë, datë: 27.08.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet **znj.Arbnorë Uka Osmani**, Ushtruese e Detyrës së Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, deri sa Ushtruesja e Detyrës së Drejtorisë së cekur **znj.Saranda Stublla Uka** të kthehet në punë nga mungesa për arsyeje personale dhe familjare.

Ky Autorizim vlen nga data e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-016/01-0053506/26
Podujevë, datë: 28.08.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

